



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.12.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore Brikena Ukperaj).

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:13 dhe mbaroi në orën 16:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)

6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore Brikena Ukperaj).
2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 16 dhjetor 2020. Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë 4 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Paraprakisht në këtë mbledhje është në pamundësi për t'iu bashkuar mbledhjes vetëm zonja Shehu për shkak të pamundësisë objektive, duke qenë se është e sëmurë.

Kalojmë në lidhje me katër çështjet që kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit. Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2020, të filluar në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, konkretisht:

1. “Për ndryshimin e pjesëshëm të vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat””.

2. “Për ndryshimin e pjesëshëm të vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Shkodër””.

3. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Pa humbur kohë le të fillojmë me dy çështjet e para, për të cilat në fakt do doja që t'ia jepja fjalën zonjës Ukperaj, si për çështjen e parë edhe për çështjen e dytë.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale janë përcjellë dy projektvendime: I pari që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për tetë kandidatë dhe i dyti ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional (kjo është procedurë normale vlerësimi) viti 2017-2019 për gjyqtaren {...}.

Duke qenë se të dy projektvendimet, dhe pse shoqërohen me dy relacione më vete, në fakt kanë lidhje me njëri-tjetrin, dhe nga ana tjetër, duke qenë se bëhet fjalë për 9 gjyqtarë të cilët ne si Komision propozojmë që të bëhet vetëm një short, pra të kemi një procedurë shorti, unë do të relatoj të dy projektvendimet së bashku, të zhvillojmë shortin dhe pastaj ne mund të kalojmë në votim për secilin prej tyre.

Lidhur me projektvendimin e parë, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në vijim të procedurave që ai zhvillon për kandidatët që aplikojnë për ngritjen në detyrë, i propozon sot mbledhjes plenare për të filluar procedurën e përshpejtuar të detyruar i cili është procesi i vlerësimit etik dhe profesional i vitit të fundit kalendarik (viti 2019), për 8 nga kandidatët të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore për ngritjen në detyrë. Një kandidat, zoti {...} është për pozicionet për të cilat ai është kualifikuar tashmë në Gjykatën e Lartë, ku ai ka aplikuar, dhe 7 kandidatët e tjerë janë kandidatë të kualifikuar për procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit.

Në relacion gjenden të pasqyruar numrat e vendimit përkatës me anë të të cilave Këshilli ka miratuar plotësimin e kriterëve ligjore prej tyre. Në tërësi bëhet fjalë për gjyqtarët z. {...} (që e relatova pak më parë), i cili është i vetmi kandidat që nuk i ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar për shkak se ishte problematika me Kodin Zgjedhor i cili edhe u ndryshua. Ndërkohë që për shtatë kandidatët e tjerë janë z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}. Këta janë 8 kandidatët për të cilët Komisioni propozon fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar.

Përveç këtyre kandidatëve, një kandidate tjetër e cila është kualifikuar gjithashtu për procedurat e ngritjes në detyrë është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Në zbatim të Rregullores dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli, edhe për këtë gjyqtare duhet të fillonte procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar. Por duke qenë se kjo procedurë fillon vetëm nëse gjyqtari e ka të plotë periudhën e ushtrimit të funksionit në vitin e fundit kalendarik, që është viti kalendarik 2019, për zonjën {...}, kjo

Iloj procedure nuk është e mundur që të fillohet sepse nga informacioni që na ka bashkëngjitur edhe kemi edhe të dërguar me e-mail nga kryetari i gjykatës, na rezulton që zonja ka afërsisht rreth 2 muaj punë në vitin 2019 dhe për këtë arsye nuk mund të vlerësohet me anë të procedurës së përshpejtuar të detyruar. Duke qenë se zonja {...} në fakt është pjesë e gjyqtarëve për të cilët është miratuar programi i vlerësimeve për vitin 2020, Komisioni propozon që ajo të vlerësohet në tërësi për periudhën 3-vjeçare (2017-2019), duke qenë se plotësohen kushtet, pra ajo ka më shumë se 1 vit në punë në tre vjet dhe njëkohësisht është kandidatë për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit.

Këto janë dy projektvendimet. Për efekt se janë dy procedura të ndryshme, janë paraqitur si dy projekt-akte me nga një relacion përkatës. Ndërkohë që lidhur me përzgjedhjen e relatorëve dhe nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, duke qenë se në tërësi bëhet fjalë për 9 kandidatë, për të garantuar barazinë e shpërndarjes së punës, do të hidhet shorti midis tre anëtarëve të këtij Komisioni dhe tre nëpunësve përgjegjës për vlerësimin që merren tashmë me vlerësimet profesionale, zonja Habili, zonja Tërpollari dhe zonja Gilda Hoxha, në mënyrë të barabartë, në të njëjtën procedurë siç kemi vepruar edhe herët e tjera, duke vendosur tre herë emrat e relatorëve dhe tre herë emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, dhe në një vend tjetër emrat e 9 gjyqtarëve. Faleminderit!

Nëse nga ana e anëtarëve të Këshillit nuk ka ndonjë koment, sugjerim, mendim apo kundërshtim lidhur me projekt-aktet, unë do propozoja që të kalojmë në procedurën e shortit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Jemi dakord me propozimin që t'i hedhim së bashku për të dy projekt-aktet?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Fillon procedura e shortit:

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve në vazon e qelqit:

z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e anëtarëve relatorë në vazon tjetër të qelqit: Brikena Ukperaj (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Brunilda Kadi (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Erjon Muharremaj (3 shirita me emrin e tij futen në enën e qelqit).

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin në vazhdim të qelqit: Esmerilda Habili (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Gilda Hoxha (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Zeta Tërpollari (3 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit).

Sipas shortit rezulton:

Përzgjidhet gjyqtari i parë, znj. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Zeta Tërpollari.

Përzgjidhet gjyqtari i dytë, z. {...}, relatores znj. Brunilda Kadi dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Zeta Tërpollari.

Përzgjidhet gjyqtari i tretë, znj. {...}, relatores znj. Brunilda Kadi dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari i katërt, znj. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari i pestë, z. {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari i gjashtë, znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet gjyqtari i shtatë, z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Zeta Tërpollari.

Përzgjidhet gjyqtari i tetë, znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet gjyqtari i nëntë, znj. {...}, relatores znj. Brunilda Kadi dhe Nëpunës Përgjegjës për Vlerësimin, znj. Esmerilda Habili.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të parë.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi: I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë si dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z.{...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

2. Për gjyqtarin z.{...}- Relator z. Erjon Muharremaj- Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

3. Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

4. Për gjyqtaren znj.{...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

5. Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

6. Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

7. Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

8. Për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik për gjyqtaren {...}. Jeni dakord me shortin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Nuk dëgjohet vota.

Alban Toro: Nuk dëgjohet vota.

Fatmira Luli: Nuk dëgjohet vota.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi: I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 dhe 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.12.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2020, të filluar në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:13 dhe mbaroi në orën 16:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2020, të filluar në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2020, të filluar në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Bici.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 10.12.2020, është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 1, shkronjat

“ç” dhe “dh” si dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjstrates {...}, të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1 e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të gjyqtarës {...}, në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Relator do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e relatorit, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Duke u bazuar në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 138 dhe vijues të ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, vlerësoj që t’i kërkoj mbledhjes plenare: Caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.03/2020, të filluar në ngarkim të magjstrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Është përgatitur edhe projektvendimi i cili përmban tre pika: 1. Caktimin e anëtarit të Komisionit të Disiplinës në cilësinë e relatorit të çështjesh.

Vendimi duhet t’i njoftohet brenda 5 ditëve Inspektorit dhe magjstrates.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pasi botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Para se të hidhet shorti unë ditën e hënë kam kaluar një vendim të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 72 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 6 të Rregullores së disiplinës, e miratuar me vendimin nr. 316/2020 të Këshillit, dua të deklaroj se kam qenë anëtar i trupit gjykues në Kolegjin Administrativ në vendimin nr. 590, datë 20.12.2016, subjekt ka qenë {...}, i paditur ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe është kundërshtuar vendimi nr. 46, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin është vendosur masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj kësaj gjyqtareje. Në çmim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse unë duhet të marrë pjesë në shortin si relator për këtë çështje. Ju faleminderit zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Kërkesën tuaj duhet ta kishim me shkrim.

Brunilda Kadi: Kryetare mundem?

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë, lidhur me atë çka parashtroi zoti Bici, mendoj se në thelb nuk ka shkaqe që zoti Bici të mos marrë pjesë në këtë procedim dhe ashtu siç ai e parashtron, referimi në mos gaboj ishte tek neni 73 i ligjit për Qeverisjen?

Medi Bici: 72-73, -po!

Brunilda Kadi: Ok! Në rast se është një nga këto rastet, ky është një vlerësim që e bën vetë anëtari, nuk ka lidhje me se çfarë vlerësojnë anëtarët e tjerë apo nuk është rasti për tërheqje dorë para Kryetarit. Unë personalisht mendoj që nuk është në kushte papajtueshmërie, për shkak të marrjes pjesë në një procedim. Kjo i përket vetë zotit Bici që ta vlerësojë. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Mund të sqarojmë pak? Zoti Bici kërkon heqjen dorë?

Medi Bici: Unë nuk kërkoja heqjen dorë. Unë dija ta bëja shkresën, por për hir të transparencës këto duhen bërë të qarta sepse nesër mund të bëhet shkak për prishjen e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Derisa unë e kam memorien e qartë para 4 vjetësh, mbaja mend që këtë gjyqtare unë e kisha gjykuar një herë. Ky është qëndrimi.

Brikena Ukperaj: Tani, duhet të ndajmë tre momente: o ka heqje dorë, o ka përjashtim...

Medi Bici: Vendimin jua kam dërguar që të hënën në orën 11:00.

Brikena Ukperaj: Na e ke dërguar vendimin.

Ka vetëm tre instrumente si mund të përjashtohet anëtari nga vendimmarrja: Nëpërmjet heqjes dorë (ju nuk keni bërë heqje dorë); kërkesë për përjashtim nuk ka, që ta shqyrtojë Këshilli; Nga ana tjetër ju vendosni të tërhiqeni vetë? Se në qoftë se ju vendosni të dilni vet, nuk e di se çfarë vendimmarrje do marrim ne? Pastaj, kjo është edhe një precedent tjetër sepse ne mund të kemi procedime disiplinore të gjyqtarëve në vazhdim dhe nëse japim masë disiplinore më të butë, pastaj nuk do hyjmë tek masa tjetër disiplinore që mund të propozohet? Janë procedime të ndryshme disiplinore.

Medi Bici: Jam dakord Brikena!

Brikena Ukperaj: Është një situatë që është për herë të parë dhe hajde ta diskutojmë me njeri-tjetrin. Ja sot ne mbledhemi dhe vendosim për një masë disiplinore për një gjyqtar, që nuk është “Shkarkim” por është “Vërejtje”, mund të jetë “Vërejtje konfidenciale”.

Medi Bici: Ligji që është sot në fuqi e parashikon sikur gjykatat të fillojnë sot nga fillimi, jo që kanë ekzistuar gjithmonë, dhe nuk e parashikon këtë rast ai. Nëse anëtari ka marrë pjesë në Komision... megjithatë unë e bëra të qartë për Këshillin, që nesër-pasnesër, mos të dali. Neni 72 e thotë të qartë, nëse ka pengesa ligjore ose ka konflikt interesi. A është pengesa ligjore kjo? Nëse nuk është, të vazhdojë shorti.

Brunilda Kadi: Mundem?

Unë mendoj që nuk është fare pengesa ligjore sepse nuk ka lidhje fare.

Mund të ketë raste për shembull unë që kam qenë anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo zoti Hallunaj, mund të ndodhë që të kemi marrë pjesë në procedime të tjera të gjyqtarëve që na vijnë përsëri, kjo nuk mund të jetë as logjike as ligjore, që të përjashtohesh nga procedura. Dua ta ritheksoj, -rasti që ngre si hipotezë zoti Bici, nuk i përket vendimmarrjes së Këshillit dhe as Kryetarit, është vendimmarrje e vetë anëtarit dhe ai përjashtohet. Kjo duhet të ishte bërë që në momentin kur ka ardhur dhe është regjistruar kërkesa. As në Komision nuk duhet të ishte trajtuar sepse ligji, dispozita e

nenit 73 thotë “as në Komision dhe as në Këshill”. Dua ta ritheksoj, që nuk është rasti që përjashtohesh Medi.

Medi Bici: Komisioni mbledhet pasi hidhet shorti.

Brunilda Kadi: E kuptoj! Sido që të jetë. Për thelbin që ka rëndësi, edhe për pjesën e procesit të rregullt, unë mendoj, në mënyrë kategorike, nuk është rasti i përjashtimit tuaj. Nuk ka lidhje fare ai procedimi ku ju keni marrë pjesë në gjykimin në Gjykatë të Lartë, me këtë procedim. Nuk ka absolutisht asnjë lloj lidhjeje. Pra ju nuk keni shfaqur mendim për këtë situatën që na ka ardhur sot. Ka lidhje ai gjykim me këtë situatën sot ku ju keni shprehur mendim? Nuk ka asnjë lloj lidhjeje. S’ka sesi të ketë?

Medi Bici: Është çështje e vitit 2012, gjykuar në vitin 2014.

Brunilda Kadi: Medi, unë e lexova edhe e-mailin tuaj edhe atë që kishit nisur, dhe mendoj që në mënyrë kategorike nuk ka lidhje fare faktet dhe rrethanat. Ju nuk jeni shprehur për këtë që është sot përpara Këshillit. Nuk ka asnjë lloj lidhjeje. Megjithatë e gjykon vet.

Medi Bici: Pse e diskutuam nuk bëjmë keq, se transparencën kërkojmë.

Brunilda Kadi: Shumë dakord. Edhe unë, në kuadër të atij diskutimi po flas.

Dritan Hallunaj: Nëse mundem Kryetare?

Naureda Llagami: Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Edhe unë jam plotësisht dakord me atë që thotë Bruna. Nuk përfshihet në asnjë nga raste e përjashtimit, përkundrazi, po të kemi parasysh edhe në mbledhjen e shkuar, ku unë isha relator tek rasti i magjistratit Kuqo, unë kam marrë pjesë edhe në një votim tjetër të këtij magjistrati, në një procedim tjetër që ai ka patur në vitin 2014, dhe unë nuk e pashë të arsyeshme dhe s’u ngrit si pretendim që të përjashtohesh nga ai shqyrtim. Prandaj unë jam tek pjesa që zoti Bici mund të marrë pjesë në short. Megjithatë, si ta vlerësoni. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Nëse jo, kalojmë në vijimin e hedhjes së shortit?

(Anëtarët bien dakord që të vijohet me hedhjen e shortit.)

Procedura e shortit:

Futen në enën e qelqit shiritat me emrat e tre anëtarëve relatorë të Komisionit Disiplinor: z. Medi Bici, z. Maksim Qoku, z. Dritan Hallunaj.

Relator për zgjidhet anëtari z. Medi Bici.

Naureda Llagami: Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. Medi Bici, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr.3/2020, në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.12.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

4.1 “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat””.

4.2 “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Shkodër””.

4.3 Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:13 dhe mbaroi në orën 16:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)

5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

4.1 “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat””.

4.2 “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Shkodër””.

4.3 Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, për të cilën, për më shumë detaje do ia kaloj fjalën zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur një projektvendim “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat””. Krahas projektvendimit ju është përcjellë edhe relacioni përkatës lidhur me këtë projektvendim.

Shkurtimisht mund t’ju relatoj se: Mbi kërkesën nr.708 prot., datë 04.11.2020, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 02.12.2020, ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, një çështje penale për të cilën kërkoheshin 3 gjyqtarë.

Për këtë kërkesë të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit si më lart të KLGJ-së, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndër të tjera, ka propozuar: “Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6.

Për 4 çështjet e para, ato nr.1-4, për të cilat kërkohen 1 dhe 3 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në këtë rast, për çështjen nr.1, me short, caktohet dhe relatori”.

Propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit, për përzgjedhjen e 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për gjykimin edhe të çështjes gjyqësore të identifikuar në tabelë me numër rendor 1.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.599, datë 02.12.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka (relator), Xhevdet Lika dhe Edvan Veçani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: (Emri dhe akuza).

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, nëpërmjet e-mailit të datës 11.12.2020, i ka bërë me dije Këshillit të Lartë Gjyqësor se:

“Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me shkresën nr.708 prot., datë 04.11.2020 është kërkuar caktimi i 3 Gjyqtareve për gjykimin e çështjes penale nr.77 regjistri datë 03.11.2020, me të pandehur: (Emri përkatës).

Nga ana e KLGJ-së, me shkresën nr.5693/1 prot., datë 04.12.2020 lënda: Njoftim mbi vendimin nr.599, datë 02.12.2020 të KLGJ-së, janë caktuar në përbërje të trupit gjykues gjyqtarët Ardit Kuka, Xhevdet Lika dhe Edvan Veçani.

Ju bëjmë me dije se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është bërë gabim shkresa që janë kërkuar 3 gjyqtarë për gjykimin e kësaj çështjeje, pasi i pandehuri akuzohet sipas nenit 290/3 K.Penal dhe duhet të gjykohet nga 1 gjyqtar.”

Po ashtu, pas njoftimit të këtij vendimi, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i caktuar relator në atë çështje, konkretisht gjyqtari Ardit Kuka, nëpërmjet e-mailit të datës 11.12.2020, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor duke i parashtruar edhe ai situatën që është çështja për të cilën janë caktuar tre gjyqtarë nga Gjykata e Dibrës në Gjykatën e Matit gjykohet nga gjyqtari i vetëm.

Sa sipër, rezulton që Vendimi i Këshillit nr.599, datë 02.12.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, pika 1, është bazuar mbi rrethana të gabuara të faktit sa i përket numrit të gjyqtarëve që duhet të caktoheshin për atë çështje gjyqësore për të cilën ajo gjykatë paraqiste nevojë, ndërsa sipas ligjit procedural penal duhet 1 (një) gjyqtar dhe jo 3 sikurse kjo gjykatë kishte kërkuar në kërkesën e saj të datës 04.11.2020.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është vendi për ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, paragrafi I, të Vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Për gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, duke mbajtur në konsideratë propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të pranuar nga Këshilli në mbledhjen e datës 02.12.2020, si dhe rezultatet e shortit të zhvilluar, si i tillë mbetet të caktohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër i përzgjedhur i pari nga shorti për këtë çështje, pra gjyqtari Ardit Kuka.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, paragrafi I, të Vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

“1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: A.D., Akuza: “Neni 290/3 i Kodit Penal”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Jemi dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, paragrafi I, të Vendimit nr.599, datë 02.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

I. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: A.D.; Akuza: “Neni 290/3 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, sërish fjala për zotin Toska.

Ilir Toska: Projekt-akti i radhës është “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Shkodër””. Edhe në këtë rast është përgatitur relacioni shpjegues i projektvendimit.

Shkurtimisht mund t’ju them se: Mbi kërkesën nr.1841 prot., datë 04.12.2020, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 10.12.2020, ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, një çështje në lëndë penale dhe është kërkuar caktimi i një gjyqtari.

Për këtë kërkesë të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisionit i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e Vendimit nr. 30/2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kritereve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-së të sipërcituar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka

propozuar: “1. Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1”.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit, për përzgjedhjen e 1 gjyqtari të Gjykatës së Apelit Durrës, për 2 çështje gjyqësore të veçanta, për të cilat nga Gjykata e Apelit Shkodër kërkohej caktimi i 1 gjyqtari në secilën çështje. Në bazë të shortit, për të dy çështjet, pra edhe për atë të identifikuar në tabelë me numër rendor 1, është caktuar gjyqtari i skemës së delegimit Florjan Kalaja, i caktuar për një periudhë 1- vjeçare pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.632, datë 10.12.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Shkodër”, pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur:

“1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: A.Sh., etj.; Akuza: Nenet 298/3, 139-25 të Kodit Penal”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Gjykata e Apelit Shkodër, nëpërmjet e-mailit të datës 11.12.2020, i ka bërë me dije Këshillit të Lartë Gjyqësor se:

“Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.588, datë 20.11.2020, për caktim gjyqtarësh në gjykata të tjera, e konkretisht vendosi: “1. Gjyqtari në skemë delegimi i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: A.Sh.; Akuza: “Neni 298/3-139-25 të Kodit Penal”.

Rezulton që Këshilli ka caktuar për të njejtën çështje përsëri gjyqtarin Florjan Kalaj. Në këto kushte është propozuar projektvendimi në rastin konkret, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative.

Sa i përket gjyqtarit që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, duhet të konsiderohen propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të pranuar në mbledhjen e datës 10.12.2020, sikundër edhe përjashtimi i gjyqtarit Florjan Kalaja, rrethanë e cila nuk është mbajtur në konsideratë në rastin e shortit të datës 10.12.2020.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Apelit Shkodër”, paragrafi I, të Vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në bazë të rezultateve të shortit, ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj, të caktohet një gjyqtar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: S.Sh. etj.; Akuza: Nenet 298/3, 139-25 të Kodit Penal.

Nëse jeni dakord, mund të procedojmë me shortin nga ana e Ermirës.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord dhe vijohet me hedhjen e shortit).

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Igerta Hysi.

Çështja e fundit e rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, ku janë përgatitur gjithsej 10 relacione.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska fillimisht relacionon shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe: I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm: 1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat; 2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë; 3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec; 4. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;

B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe: I. Gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm: 1. Gjykata e Apelit Durrës; 2. Gjykata e Apelit Shkodër.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: Z. Ded Miri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Olti Skrame dhe Aurel Arapi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, konkretisht: Znj. Alma Kolgjoka.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për të cilën ka filluar procedimi disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, konkretisht: Znj. Enkeleida Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Arnisa Këlliçi dhe Elizabeta Gjoni.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Elizabeta Gjoni.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë deri në gjashtë.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për çështjet nr.1 dhe nr.2, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast, me short, caktohet dhe relatori.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes nr.2 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i caktuar më parë për gjykimin e çështjes, konkretisht: Z. Xhevdet Lika.

Në shortimin e çështjes nr. 3 të përjashtohet nga shorti Kryetarët në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 7 (shtatë) apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Albert Meça, Z. Bedri Qori, Z. Gerd Hoxha, Znj. Ardiana Bera, Z. Sokol Tona, Z. Kujtim Vraniçi; Z. Kreshnik Omari, Z. Kastriot Gramshi, Z. Sokol Pasho, Z.Ahmet Metaliaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Edvan Veçani dhe Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Xhevdet Lika.

Për çështjen nr.3, penale, gjyqtarët Armela Hasantari (relator), Lazër Sallaku dhe Artan Gjërmeni (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën

e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 dhe ai të përzgjidhet nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në GJPSHPKKO, konkretisht: Z. Rexhep Bekteshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Eda Kaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Korçë konkretisht: Znj. Luljeta Kole.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e saj ose që kanë pengesë ligjore, konkretisht: Z. Ervin Sulaj; Znj. Eglantina Mikani.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Besnik Shehu; Z. Maksim Qirjazi; Z. Arben Lera; Znj. Ariola Kristo; Z. Seladin Pysqyli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Thomaidha Roça.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, konkretisht: Znj. Yrfet Shkreli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Gjergji Baçi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për kërkesën me numër rendor 1, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë parashtron se: “Me Vendimin nr.258, datë 12.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar në përbërje të trupit gjykues gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia dhe Vjola Canaj. Me vendimin nr.403 dhe nr.404 datë 07.10.2020, gjyqtari Laurent Fuçia është komanduar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe për këtë shkak nevojitet plotësimi i trupit gjykues të kësaj çështje me një gjyqtar tjetër”.

Ndërsa për kërkesën me numër rendor 2, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë parashtron se: “Kërkohet delegim, pasi është pranuar kërkesa për heqje dorë e gjyqtares Suela Xhani me Nr.180/1 prot., datë 17.11.2020, ... Kërkohet delegim për gjyqtarin Sokol Pina , i cili është deleguar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”.

Në përgjigje të kërkesës për informacion, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me e-malin e datës 15.12.2020, në lidhje me kërkesën nr. 311 prot., datë 09.12.2020, ka informuar se (çështja nr. 1 në relacion): “Për çështjen me të pandehur Elida Lamçe etj, akuzuar për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale” parashikuar nga Neni 287 K.Penal, për të cilën ka qenë kryesuese gjyqtare Suela Dashi si dhe anëtarë të trupit gjykues anëtarët Laurent Fuçia dhe Vjola Canaj. Gjyqtari Laurent Fuçia i emëruar në Gjykatën e Apelit Vlorë nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga kjo çështje. Kërkesa për plotësimin e trupit gjykues është bërë nga kryesuesja e trupit gjykues gjyqtare Suela Dashi. Gjykimi është në fazën e kërkesës së avokatit Bajram Koli për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare”.

Ndërsa në lidhje me kërkesën me nr. 315 prot., datë 09.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me e-malin e datës 15.12.2020, ka informuar se (çështja nr. 2 e relacionit):

“Në lidhje kërkesën nr. 315 prot., datë 09.12.2020, për të pandehurin T.A., akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni

283/2 K.Penal, ku kryeson gjyqtarja Suela Dashi dhe anëtarë trupi gjykues Suela Xhani dhe Sokol Pina.

Ju bëjmë me dije se gjyqtare Suela Xhani ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështje, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 180/1 prot., datë 17.11.2020, nga Zv/Kryetari Arben Dosti. Gjyqtari Sokol Pina i emëruar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër me vendimin 547 datë 05.11.2020 nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga kjo çështje. Kërkesa për plotësimin e trupit gjykues është bërë nga kryesuesja e trupit gjykues gjyqtare Suela Dashi.

Për këtë çështje kërkohet plotësimi i trupit gjykues me 2 anëtarë. Gjykimi është në fazën e marrjes dhe shqyrtimit të provave të paraqitur nga prokuroria dhe mbrojtja”.

Nisur nga sa rezulton nga aktet, në lidhje me çështjen sipas kërkesës me numër rendor 1 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, rezulton që Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.258, datë 12.11.2019, ka disponuar për caktimin e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia dhe Vjola Canaj, për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e asaj çështje në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate, për gjykimin e saj. Sipas akteve nuk rezulton që gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues të kenë dhënë dorëheqje apo të jenë përjashtuar nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, komandimi në skemën e delegimit i gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia, si dhe caktimi i tij për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një periudhë 1-vjeçare, nuk zhbëjnë Vendimin e Këshillit nr.258, datë 12.11.2019, për caktimin e tij për plotësimin e trupit gjykues në çështjen në nevojë si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Po ashtu, nga sa rezulton nga aktet, në lidhje me çështjen sipas kërkesës me numër rendor 2 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, rezulton që Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimet nr.285, datë 16.12.2019 dhe nr.30, datë 21.01.2020, ka disponuar për caktimin e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Sokol Pina dhe Suela Xhani, për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e asaj çështjeje në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër) për gjykimin e saj. Sipas akteve, vetëm për një nga gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues ka të dhënë për dorëheqje nga gjykimi i çështjes, dorëheqje e cila është miratuar, ndërsa gjyqtarët e tjerë nuk rezulton të kenë dhënë dorëheqje apo të jenë përjashtuar nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, komandimi në skemën e delegimit i

gjqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Sokol Pina, si dhe caktimi i tij për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër për një periudhë 1-vjeçare, nuk zhbëjnë Vendimin e Këshillit nr.285, datë 16.12.2019, për caktimin e tij për plotësimin e trupit gjykues në çështjen në nevojë si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër.

Në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor ku bazohet kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, konkretisht në Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, Kreun III të tij, përcaktohet se “Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë” nënkupton caktimin e një gjyqtari, nga gjykata ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në një gjykatë tjetër, kur kjo e fundit ka një nevojë konkrete që lidhet me gjykimin e një ose disa çështjeve gjyqësore”, sikurse po ashtu përcaktohet edhe se: “Nevojat e gjykatës” nënkupton mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të gjyqtarëve të një gjykate për gjykimin e një apo disa çështjeve gjyqësore”.

Ndaj sa më sipër, është rasti që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë refuzimin e kërkesës me numër rendor 1 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, si dhe të vijojë trajtimin e kërkesës me numër rendor 2 të kësaj gjykate, duke konsideruar që është në nevojë për caktimin vetëm të 1 gjyqtari.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.311 prot., datë 09.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, për caktim gjyqtari, në çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: E.L, etj; akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”.

(Anëtrëti e Këshillit janë dakord.)

Vijohet më tej me relacionin.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, sa i përket kërkesës me numër rendor 2, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Yrfet Shkreli.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që do të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, që rezultoi gjyqtar Gjergji Baçi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Mariola Beluli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe

kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Valbona Vata.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër**, ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Desart Avdulaj.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e 15 apo më shumë çështjeve në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z.Izet Dushaj; Znj.Anita Mici; Z.Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtar Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm.

Gjyqtarët për 1 çështje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhen, me short, ndërmyjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: Znj.Miranda Andoni.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e një apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: Z.Astrit Kalaja; Znj.Anita Mici; Z.Dritan Banushi; Z. Enton Dhimitri; Znj.Edlira Petri; Znj.Irena Brahimi; Znj.Margarita Buhali; Z.Ridvan Hado

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Me kaq mbyllen në tërësi procedurat e shortit dhe Mbledhja Plenare.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor